

VENDIM
Nr. 694, datë 22.10.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR.228, DATË 29.2.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË –
ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.228, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë bujqësore dhe truall prej 620 006 (gjashtëqind e njëzet mijë e gjashtë) m², me vlerë të përgjithshme 208 317 929.2 (dyqind e tetë milionë e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e nëntë pikë dy) lekë, për objekte me vlerë 157 232 702 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 365 550 631.2 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pikë dy) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 10 637 500 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 365 550 631.2 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pikë dy) lekësh të përballohet, si më poshtë:

a) 214 557 515 (dyqind e katërmëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

b) 124 300 000 (njëqind e njëzet e katër milionë e treqind mijë) lekë, nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitin

2012.

c) 26 693 116.2 (njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë dy) lekë, të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2014 (zëri “Shpronësimet”), planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, shtohen listat që ibashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
 SEGMENTIT RRUGOR TIRANË-ELBASAN (SHITESAT)

Nr.	PRONARI	Nr. pas	ZK	TOKË			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri, atësia, mbiemri			Sip (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera(lekë)		
1	Halil Rama	302/5	2704	1839	2622.165	4822161.435	4822161.435	Konfirmim ZVRPP
2	Astrit Rama	302/8	2704	1400	2622.165	3671031	3671031	Konfirmim ZVRPP
3	Agim Selman Gjocaj Altin Xhevdet Bamllari Enkel Xhevdet Bamllari Roland Ali Bamllari	454/9	2704	2145	2622.165	5624543.925	5624543.925	Konfirmim ZVRPP
	TOTALI			5384		14117736.36	14117736.4	

Nr .	PRONARI	Zk	Nr. pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	VLERËSIMET			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri i pronarit					Sip (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera(lekë)		
1	Kadri Fadil Brahja	326 6	168/53	Arë	2600	2600	2622.165	6817629	6817629	Konfirmim ZVRPP
2	Syrja Hamdi Dervishi	273 5	127/5	Arë	7300	4266	233	993978	993978	Konfirmim ZVRPP
3	Syrja Hamdi Dervishi	273 5	125/15	Ullishte	2700	2074	233	483242	483242	Konfirmim ZVRPP
4	Selman Sejdin Dervishi	273 5	125/13	Arë	1300	484	233	112772	112772	Proces konfirmimi
5	Selman Sejdin Dervishi	273 5	127/4	Arë		4710	233	1097430	1097430	Proces konfirmimi
6	Lulzim Qamil Haxhiu	273 5	217/30	Truall	1200	650	1919.2	1247480	1247480	Konfirmim ZVRPP
7	Festim Stafa	117 0	126/132	Arë	560	271	322	87262	87262	Konfirmim ZVRPP
8	Gani Haxhi Gjuzi	117 0	126/127	Arë	2310	330	322	106260	106260	Konfirmim ZVRPP
9	Enver Mersin Tarja	117 0	122/17	Arë	3190	802	322	258244	258244	Konfirmim ZVRPP
10	Sherif Shaqir Gjuzi	117 0	126/114	Arë	5140	2589	322	833658	833658	Proces konfirmimi
11	Fatmir Velia	275 2	22/1	Ullishte	650	650	254	165100	165100	Konfirmim ZVRPP
12	Zyber Tarja	275 2	57/2/1	Truall		194	1919.2	372324.8	372324.8	Proces konfirmimi
	TOTALI					19620		12575379.8	12575379.8	